



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 5 Maj 2022

Nr. 156

V E N D I M

PËR

PËR ZGJATJEN E AFATIT TË SHOYRTIMIT ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT TË ORGANIZATËS “QËNDRESA QYTETARE”, NDAJ ZJ. EMIRIANA SAKO, KANDIDAT PËR KRYETAR TË BASHKISË DURRËS, Z. ARBEN AHMETAJ, MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E REFORMAVE DHE SUBJEKTIT ZGJEDHOR “PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË”, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE NË KUADËR TË FUSHATËS ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.04.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Referuar nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë



Data: 5 Maj 2022

Nr. 156

“Për zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës “Qëndresa Qytetare”, ndaj zj. Emiriana Sako, kandidat për kryetar të bashkisë Durrës, z. Arben Ahmetaj, Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 7, të vendimit nr. 9, datë 09.04.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

- 1- Komisioneri fillon procedurën administrative dhe hetimin administrativ kryesisht me deponimin e denoncimit në Portalin e Denoncimeve ose kur ajo mbërrin drejtpërdrejtë në KQZ.
- 2- Afati që ka KQZ-ja për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga paraqitja e tij.
- 3- Afati i parashikuar në pikën 2, të këtij neni mund të zgjatet me vendim me shkrim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kur çështja është komplekse ose është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë.

Lidhur me denoncimin e Organizatës “Qëndresa Qytetare”, ndaj zj. Emiriana Sako, kandidat për kryetar të bashkisë Durrës, z. Arben Ahmetaj, Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, pretendohet se, *“Në datë 03.03.2022 në Njësinë Administrative të Manzës, kandidatja e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Emiriana Sako, e shoqëruar nga zv.kryeministri njëkohësisht dhe Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, z. Arben Ahmetaj, me pjesëmarrjen e banorëve të zonës, përfitues nga këto investime, promovuan zonën e re të banimit në Manëz, ku kanë përfunduar disa njësi banimi. Gjatë këtij takimi, sikurse vërehet nga statusi në profilin personal në Facebook të kandidatës, zj. Emiriana Sako dhe z. Arben Ahmetaj, në këtë takim është bërë promovimi i investimeve vendore në atë zonë duke mbështetur dhe promovuar objekte të rindërtuara si pasojë e fatqësive natyrore. Ky aktivitet vjen në një kohë që përkon me fushatën zgjedhore. Ndër të tjera, në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, rezulton një takim i raportuar nga bashkia Durrës në datë 01.03.2022, i cili i referohet një takimi me titull “Inspektim në terren në sitin e Manzës” i cili nuk përmbush kriteret e parashikuara nga neni 92, i Kodit Zgjedhor për sa i përket elementëve si afati 5 ditor i raportimit në ndërfaqe, lloji dhe folësit kryesorë të takimit ku ndër to mungon z. Ahmetaj”, veprimtari e kryer në kundërshtim me nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.*

Edhe pse ka përfunduar afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor i shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi administrativ është ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3 e vendimit nr. 9, datë 09.04.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VENDOSI:

1. Zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës “Qëndresa Qytetare”, ndaj zj. Emiriana Sako, kandidat për kryetar të bashkisë Durrës, z. Arben Ahmetaj, Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 5 Maj 2022

Nr. 156

“Për zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës “Qëndresa Qytetare”, ndaj zj. Emiriana Sako, kandidat për kryetar të bashkisë Durrës, z. Arben Ahmetaj, Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”